



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 90, Datë 08/09/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 9, datë 29.01.2019, e Z. E. A. dhe Z. F. M., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”, “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Bashkisë Pogradec.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Z. E.A.dhe F.M. janë strehuar që prej vitit 1985, në objektin ndihmës<sup>2</sup> pranë Maternitetit të Vjetër, me Nr. Pasurie vol.1/19, në Pogradec. Të dy ankuesit kanë banuar 33 vjet me qera në këtë banesë shtetërore dhe pretendojnë se ish-banesa e tyre është ende në pronësi të shtetit. Në datën 14.06.2018, në bazë të Urdhërit të Ekzekutimit të Vendimit nr. (896) – 295, datë 11.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, lëshuar për titullin ekzekutiv Vendimi nr. 295, datë 11.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, familjet e të dy ankuesve e kanë liruar banesën. Ankesa e tyre drejtohet kundër Bashkisë Pogradec, pasi ata pretendojnë se ky institucion është bërë pengesë, që ata të privatizonin këtë banesë. Z. E.A. pretendon se është diskriminuar, për shkak të racës, pasi ai i përket komunitetit egjiptian<sup>3</sup>, për shkak të gjendjes ekonomike, pasi është i papunë, si dhe për shkak të gjendjes së tij

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

<sup>2</sup> Ankuesit pretendojnë se familjet e tyre kanë ndarë të njëjtën banesë së bashku.

<sup>3</sup> Referuar Vërtetimit nr. 16, datë 15.12.2018, të Shoqatës “Vllazëria Egjiptiane;.

shëndetësore<sup>4</sup>. Ndërkohë që, Z. Flori Menkshi, i cili nuk i përket komunitetit egjiptian pretendon se diskriminohet për shkak të gjendjes ekonomike, pasi është i papunë dhe gjendjes shëndetësore të djalit të tij<sup>5</sup>.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 9, datë 29.01.2019, së Z. E.A.dhe Z. Flori Menkshi, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>6</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Pogradec, me shkresën nr. 155/1, datë 06.02.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
1. Kontratat e qerasë me shtetin dhe inventarët e banesave shtetërore për secilin prej tyre;
  2. Kopje e Urdhërit të Ekzekutimit mbi Vendimin Nr. (896) – 295, datë 11.11.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
  3. Kopje e Vendimit nr. 295, datë 11.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
  4. Kopje e çertifikatës së pronësisë dhe planimetrisë përkatëse për pasurinë 19/1, vol. 17, fq. 247, Pogradec;
  5. Kopje e praktikës për ekzekutim vendimi gjyqësor;
  6. Informacion nëse ankuesit kanë paraqitur kërkesë për legalizimin e banesës dhe nëse është dhënë miratimi përkatës nga ana e Bashkisë Pogradec. Të dërgohen bashkëlidhur kopje e kërkesave përkatëse dhe përgjigjeve zyrtare të dërguara;
  7. Masat e marra nga Bashkia Pogradec për sistemimin dhe akomodimin e familjeve të ankuesve;
  8. Çdo akt tjetër administrativ, që ka lidhje me çështjen në shqyrtim;

---

<sup>4</sup> Referuar librezës së verbërisë nr. 18617, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

<sup>5</sup> Referuar kopjes së librezës së lëshuar nga Shoqata e Personave të Paafhtë.

<sup>6</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Në përgjigje të shkresës nr.155/1, datë 06.02.2019, të Komisionerit, Bashkia Pogradec dërgoi shkresën nr.1177/1, datë 11.02.2019, nëpërmjet së cilës, sqarohet se familjet e Z. F.M.dhe Z. E.A.kanë banuar në banesën me numër pasurie 1/19, e cila sipas informacionit të dërguar nga ZVRPP Pogradec, rezulton në pronësi të vllazërisë Petro, Kristaq, Sotir dhe Pirro K., në Zonën Kadastrale nr. 8582, të pajisur me certifikatë pronësie në datën 29.06.2005.

Për sa më sipër, Bashkia Pogradec informon se nuk i disponon vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor Pogradec, sikurse edhe certifikatat e pronësisë apo kërkesat për legalizim. Objekti në fjalë, nuk figuron në listat e aseteve të Bashkisë Pogradec, si truall dhe si godinë, prandaj pretendimi për privatizim nëpërmjet Bashkisë Pogradec është i perealizueshëm.

Në shkresën e mësipërme kundërshtohen pretendimet e dy ankuesve për diskriminim për shkak të racës, gjendjes ekonomike apo gjendjes shëndetësore. Bashkia Pogradec thekson faktin se strukturat e saj përgjegjëse, në çdo rast, i kanë ndihmuar dhe orientuar ankuesit për problemin e parashtruar. Pas ekzekutimit të kryer nga ana e shërbimit përmbartimor privat, për përmbushjen e titullit ekzekutiv për lirim dhe dorëzimin e pronës së lartpërmendur, pronarëve të ligjshëm, Këshilli Bashkiak ka marrë masat e nevojshme, duke nxjerrë Vendimin nr. 64, datë 27.06.2018, nëpërmjet së cilit është miratuar pagesa e qerasë për një periudhë 6-mujore për familjet e Z. Flori Menkshi, E.A.dhe Eliverta Hoxhalli, nga fondet e Bashkisë Pogradec. Njëkohësisht, emrat e familjeve të dy ankuesve figurojnë në listat e të pastrehëve të kategorisë së parë (banues në ish-pronë private), për të cilët ekziston mundësia e përfitimit të kredive të lehtësuara me 0% interes.

- Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, Komisioneri iu drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Pogradec, nëpërmjet shkresës nr. 155/4, datë 08.03.2019, ku kërkohej informacion, si vijon:
  - ✓ Informacion mbi pronësinë aktuale të pasurisë nr.1/19, Zona Kadastrale nr. 8582, vol. 13, fq. 51, Pogradec. Për sa më sipër, lutem të përcillet pranë Komisionerit, vertetimi i pronësisë mbi këtë pasuri;
  - ✓ Informacion mbi faktin nëse ka patur ndryshime të pronësisë së kësaj pasurie nga viti 1991 e në vijim. Nëse po, lutemi të identifikohen sipas periudhave kohore, pronarët e kësaj pasurie, të citohen aktet që kanë ndryshuar pronësinë e kësaj pasurie, si dhe të dërgohet një kopje e këtyre akteve në adresë të Komisionerit;
- Në përgjigje të shkresës nr. nr. 155/4, datë 08.03.2019, të Komisionerit, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Pogradec dërgoi shkresën nr. 449, datë 25.03.2019, nëpërmjet së cilës sqaron se pasuria nr. 1/19, e ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 8582, Volumi 13, faqe 51, është pasuri e llojit truall me sipërfaqe 345.8 m<sup>2</sup>, nga të cilat 216.8 m<sup>2</sup> janë ndërtesë. Kjo pasuri është e

regjistruar në bashkëpronësi, në emër të Petro Jovan K., Kristaq Jovan K., Sotir Jovan K., sipas Vendimit nr. 240, datë 22.02.1999, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Pogradec, Dëshmisë së Trashëgimisë nr. 214, datë 19.10.1993, si dhe Çertifikatës së Pronësisë nr. 423, datë 14.10.1995. Lidhur me çështjen e dytë, ZVRPP Pogradec sqaron se ky ka qenë regjistrimi i parë dhe i vetëm që i është bërë kësaj pasurie.

Në shkresën e sipërpërmendur, ZVRPP Pogradec thekson faktin se Z. F.M. ka aplikuar pranë këtij institucioni për regjistrimin e kësaj pasurie në datën 14.01.2015. Çështja e tij është trajtuar nga ZVRPP Pogradec dhe ankuesi ka marrë përgjigje zyrtare negative, pasi Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme në Tiranë ka nxjerrë Urdhër Refuzimi nr. 126, datë 05.03.2015, lidhur me këtë regjistrim.

Në vijim, ZVRPP Pogradec informon se me anë të shkresës nr. 511/1, datë 17.03.2015, të ZVRPP Pogradec, Z. F.M. është informuar mbi rrugën që duhet të ndiqte në vijim. Në këtë kontekst, ZVRPP Pogradec kundërshton pretendimin për diskriminim, për shkaqet e sipërpërmendura, të dy ankuesve.

Bashkëlidhur shkresës nr. 449, datë 25.03.2019, ZVRPP Pogradec dërgoi për dijeni të Komisionerit dokumentacionin tekniko-ligjor, mbi të cilin është regjistruar pasuria nr. 1/19, e ndodhur ne Zonën Kadastrale nr. 85.82, si dhe Urdhërin e Refuzimit nr. 126, datë 05.03.2015, të ZVRPP Tiranë.

- Ndërkohë, ankuesit F.M.dhe E.A. dërguan pranë Komisionerit, shkresën nr. 155/3, datë 20.02.2019 dhe shkresën nr. 155/3, datë 13.03.2019, bashkëlidhur së cilave u dërguan disa dokumente në cilësinë e provës, të tilla si: kontrata e qirase me shtetin, për ish-banesën e tyre, inventari shoqërues, librezat e pagesës së energjisë elektrike, shkresat e shërbimit përmbartimor privat dërguar ankuesve për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, harta treguese të regjistrimit për pasurinë 1/19, vol 13, fq. 51, lëshuar nga Regjistruesi Majlind Shkira, (ku nuk rezultojnë të dhëna mbi pronarin e truallit), planvendosje të tjera të hartuara nga topografë privatë, ku pasuria 1/19 rezulton me pronar shtet, shkresën nr. 674, datë 28.02.2018, e ZVRPP Pogradec nëpërmjet së cilës rezulton se pasuria nr. 19/1, vol 17, fq. 247, me sip 544 m<sup>2</sup> tokë arë është në pronësi shtet, shkresën nr. 188, datë 22.04.2016, të Bashkisë Pogradec drejtuar Z. Menkshi, etj.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga ankuesit, ZVRPP Pogradec ka bërë mbivendosje të pronave, ka bashkuar Spitalin me nr. Pasurie 1/20, me banesën ku ata kanë jetuar, të ndërtuar në vitin 1974, me nr. pasurie 1/19 – 193 m<sup>2</sup> truall dhe 100 m<sup>2</sup> ndërtesë, Vol 13, fq. 51, ZK. 8582. Ata theksojnë faktin se pasuria e sipërpërmendur, në vitin 2016, mori emërtimin pasuri me nr. 19/1, volumi 17, fq. 247, ZK.8582.

- C. Nw vijim të procedurave hetimore, u vendos të realizohet një seancë dëgjimore në datën 17.04.2019, ora 12:00. Në këtë ankesë u ftuan për pjesëmarrje përfaqësues të Bashkisë Pogradec dhe ZVRPP Pogradec.

Në këtë seancë, u paraqitën vetëm ankuesit dhe seanca u zhvillua në mungesë të përfaqësuesve të institucioneve të sipërpërmendur. Në këtë seancë dëgjimore, ankuesit parashtruan edhe një herë pretendimet e tyre lidhur me objektin e ankesës. Ata pretenduan se diskriminohen për shkak të “racës”, “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Bashkisë Pogradec, pasi kjo e fundit është bërë pengesë për privatizimin e banesës në të cilën ata kanë jetuar me qera shtetërore. Pyetjes se për cilën pasuri kanë pretendime, Z. F.M. dhe Z. Enever E.A.u shprehën se pretendimi i tyre drejtohet kundrejt pasurisë nr. 1/19, vol 13, fq. 151, e cila prej 2016 ka marrë emërtimin pasuria nr. 19/1. Ata pretenduar faktin se aktualisht pasuria nr. 1/19, e ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 8582, Volumi 13, faqe 51, është reregjistruar me nr. 19/1, vo l 17, fq. 247 dhe se trashëgimtarët K. nuk ishin pronarë të ligjshëm të pronës dhe ish-banesës, ku ata kanë banuar. Në kushtet kur, për pasurinë në fjalë ka një vendim të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Pogradec, që cakton pronarë familjen K. dhe në kushtet kur ankuesit pretendojnë se kjo pasuri ka pronar shtetin, ankuesit u pyetën nëse ka ndonjë vendim gjykate që e ka rrëzuar vendimin e KKKP Pogradec. Ankuesitu përgjigjën që nuk ka një vendim gjykate që rrezon vendimin e Komisionit të Kthimit dhe kompensimit të Pronave Pogradec.Z. F.M.u shpreh se kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr.78, datë 27.02.2015, të gjykatës së rrethit gjyqësor Pogradec dhe vendimit nr. 340, datë 12.11.2015 të Gjykatës së Apelit Korçë. Ankuesve iu kërkua të depozitonin kopje të këtyre vendimeve, si dhe rekursit. Të dy ankuesit u shprehën se Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Pogradec ka lëshuar dokumente të fallsifikuara, në lidhje me ish-banesën e tyre dhe se atat kanë bërë kallëzim penal ndaj saj. Të pyetur nëse ata e kanë ankimuar Urdhërin e Refuzimit të Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtëshme, që nuk i lejon të kryejnë regjistrimin e ish-banesës së tyre, ankuesit u përgjigjën se nuk e kanë ankimuar këtë akt administrativ.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Pogradec dërgoi pranë Komisionerit shkresën nr. 2462/1, datë 16.04.2019, nëpërmjet së cilës informon se KMD-së i është kthyer përgjigje edhe më parë lidhur me problematikën e parashtruar nga ankuesit, ku thekson faktin se dokumnetacioni tekniko-ligjor i depozituar nga ankuesit nuk është i saktë dhe është refuzuar nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Tiranë, në datën 05.03.2015. Në shkresë theksohet fakti se Z. F.M. është trajtuar brenda afatit ligjor, pranë ZRPP Pogradec, ku i është dhënë edhe zgjidhja që duhet të ndiqte për të përfitimin e pronës së pretenduar nga ana e tij. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Pogradec regjistron dokumenta, të cilat përbëjnë titull pronësie dhe në qoftë se dokumentat nuk janë të plota si në rastin e Z. Menkshi, pasuria nuk mund të regjistrohet, ndaj atij i është kthyer përgjigje negative. Z. F.M. është udhëzuar për t’iu drejtuar gjykatës për zgjidhjen e kësaj çështjeje.
2. Komisioneri iu drejtua Zyrës Rajonale të Regjistrimit të pasurive të Paluajtëshme Pogradec dhe për dijeni Bashkisë Pogradec dhe ankuesve, me anë të shkresës nr. 79/3, datë 08.05.2019, ku kërkoi informacionin e mëposhtëm:

- Informacion mbi pronësinë aktuale të pasurisë nr. 19/1, vol. 17, fq. 247 Pogradec. Të përcillet pranë Komisionerit, vertetimi i pronësisë mbi këtë pasuri.
- Informacion nëse pasuria nr. 19/1, vol. 17, fq. 247 Pogradec, është ri-regjistrim me të dhëna të reja i pasurisë nr.1/19, Zona Kadastrale nr. 8582, vol. 13, fq. 51, Pogradec.
- Çdo informacion tjetër që ju mendoni se është i nevojshëm për sqarimin e situatës në fjalë.

✓ Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Pogradec nuk i ktheu përgjigje shkresës së Komisionerit.

3. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtua zyrtarisht nëpërmjet shkresës nr. 686, datë 08.05.2019, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Apelit Korçë, ku kërkoi të administrontë kopje të vendimit nr. 78, datë 27.02.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe vendimit nr. 340, datë 12.11.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë, vendime të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me ankuesit e sipërpërmendur dhe me çështjen në shqyrtim.

✓ Në përgjigje të kërkesës së KMD-së gjykatat e sipërpërmendura dërguan vendimet e kërkuara<sup>7</sup>.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 9, datë 29.01.2019, së Z. E.A.dhe Z. F. M., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Në ankesën nr. 9, datë 29.01.2019, e Z. E.A.dhe Z. F. M., pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”, “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Bashkisë Pogradec.

Për sa më sipër, në bazë të Vendimit nr. 614, datë 07.07.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyera në fond banesë, me vendime qeverie të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njësisve të qeverisjes vendore dhe të shtetit, ku janë sistemuar me strehim banorë të pajisur me autorizim nga organet kompetente”, njësitë e qeverisjes vendore nënshkruajnë kontratat e privatizimit në cilësinë e

<sup>7</sup> Referuar shkresës nr. 686/2, datë 13.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe shkresës nr. 686/3, datë 15.05.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë.



palës që kryen privatizimin e banesave shtetërore me subjektet përfituese, për ato banesa të cilat kanë pronar shtetin dhe janë të regjistruara në emër të bashkisë. Proçedura që ndiqet për privatizimin e këtyre banesave përshkruhet hollësisht në vendimin e sipërpërmendur. Me hyrjen në fuqi të kësaj VKM-je, ankuesit F.M.dhe E.A. kanë aplikuar pranë Bashkisë Pogradec për të përfituar banesën e ndodhur në rrugën “Reshit Çollaku” në Pogradec, me nr. pasurie 1/19, e ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 8582, Volumi 13, faqe 51, për të cilën I kanë paguar qera shtetit që prej vitit 1986, por Bashkia Pogradec nuk e ka kryer proçesin e privatizimit për këtë banesë, pasi kjo banesë nuk ndodhet e regjistruar në emër të saj, por ndodhet në pronësi private.

Sipas informacionit të administruar gjatë proçesit të hetimit administrativ rezultoi se pasuria nr. 1/19, e ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 8582, Volumi 13, faqe 51, është pasuri e llojit truall me sipërfaqe 345.8 m<sup>2</sup>, nga të cilat 216.8 m<sup>2</sup> janë ndërtesë. Aktualisht rezulton se pasuria e mësipërme është e regjistruar në bashkëpronësi, në emër të P. J. K., K. J. K., S. J. K., sipas Vendimit nr. 240, datë 22.02.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Pogradec, Dëshmisë së Trashëgimisë nr. 214, datë 19.10.1993, si dhe Çertifikatës së Pronësisë nr. 423, datë 14.10.1995. Ky ka qenë regjistrimi i parë dhe i vetëm që i është bërë kësaj pasurie, me miratimin e Vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Pogradec.

Nga dokumentacioni i depozituar në cilësinë e provës rezulton se Z. F.M. ka aplikuar paraprakisht, në datën 14.01.2015, pranë ZVRPP Pogradec, për regjistrimin e pasurisë së sipërpërmendur, në emër të tij. Çështja e tij është trajtuar nga ZVRPP Pogradec dhe ankuesi ka marrë përgjigje zyrtare negative, pasi Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme në Tiranë ka nxjerrë Urdhër Refuzimi nr. 126, datë 05.03.2015, lidhur me këtë regjistrim. Në urdhërin e sipërpërmendur citohet: “ .....në regjistrat publikë të pasurisë së paluajtëshme figuron e regjistruar pasuria me nr. 1/19, Vol. 13, fq. 51, pasuria me sip. 345.8 m<sup>2</sup> truall dhe 216.8 m<sup>2</sup> ndërtesë në emër të Petro Kreste, Kristaq Kreste, Sotir Kreste, Pirro Kreste. Kjo pasuri është regjistruar sipas vendimit nr. 240, datë 22.01.1995, të K.K.K. Pronave të Bashkisë Pogradec në përputhje me nenin 193, të Kodit Civil.

*Dokumenti i paraqitur nga ana juaj është kontrata e qerasë të lidhur me Ndërmarrjen Komunale Banesa Pogradec me dt. 02.04.1986. Ky dokument nuk përbën akt të fitimit të pronësisë sipas përcaktimeve ligjore të bëra në nenin 193, të Kodit Civil. Në këto kushte, në mungesë titulli pronësie sipas nenit 193 të Kodit Civil dhe nenit 25 a, të ligjit nr. 333, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtëshme” duhet të refuzohet....”.*

Për sa më sipër, rezulton se Z. F.M.nuk e ka kundërshtuar gjyqësisht brenda afatit ligjor Urdhër Refuzimin nr. 126, datë 05.03.2015, e Kryeregjistruesit të ZQRPP-së.

Vendimi nr. 240, datë 22.02.1995, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Pogradec u ekzekutua plotësisht, kur në datën 14.06.2018, në bazë të Urdhërit të Ekzekutimit të Vendimit nr. (896) – 295, datë 11.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, lëshuar për

titullin ekzekutiv Vendimi nr. 295, datë 11.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, shërbimi përmbartimor i ka detyruar familjet e të dy ankuesve të lirojnë banesën.

Ankuesit kanë kërkuar gjyqësisht pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv të cituar më sipër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec nëpërmjet vendimit nr. 78, datë 27.02.2015, ka vendosur rrezimin e kërkesëpadisë së tyre. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 340, datë 12.11.2015, e Gjykatës së Apelit Korçë. Ankuesit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

Për sa më sipër, Komisioneri jep gjykimin e tij, vetëm në lidhje me ankesën e ankuesve F.M.dhe Enver Ademi, e cila drejtohet kundër Bashkisë Pogradec, pa ndërhyrë në çështjet mbi konfliktet e pronësisë, që ata kanë me pronarët e ligjshëm të kësaj pasurie. Në kushtet kur, pasuria, objekt i kësaj ankese rezulton në pronësi private, Komisioneri gjykon se Bashkia Pogradec nuk është e autorizuar për të kryer procedurën e privatizimit në bazë të Vendimit nr. 614, datë 07.07.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyer në fond banese, me vendime qeverie të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njësisive të qeverisjes vendore dhe të shtetit, ku janë sistemuar me strehim banorë të pajisur me autorizim nga organet kompetente.*

Komisioneri sugjeron që çështjet, që lidhen me problemet e pronësisë së pasurisë së sipërpërmendur, ankuesit t'i zgjidhin në rrugë gjyqësore.

Në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, Komisioneri gjykon se ankuesit F.M.dhe E.A. nuk janë ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Bashkisë Pogradec. Në mungesë të një trajtimi të tillë nuk ka diskriminim për shkaqet e pretenduara.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të Z. E.A.dhe Z. Flori Menkshi, për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga ana Bashkisë Pogradec.



2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

Fusha: te mira dhe sherbime

Shkak: "raca", "gjendja ekonomike" dhe "gjendja shëndetësore"